

# Aksesi në Financim: Financimi i Shërbimeve të Bashkive të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve



**PËRFTIMI** i përvojës praktike mbi konceptet bazë financiare dhe menaxhimin e aspekteve financiare

**SHKËMBIMI** me profesionistët e tjerë në këtë sektor

**PËRDITËSIMI** mbi tendencat më të fundit në këtë sektor

**PËRFITIMI** nga përvojat rajonale dhe globale nga shoqëri të tjera

# Aksesi në financim: Financimi i Shërbimeve të Bashkive të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

Ky program është zhvilluar për dy grupe të ndryshme:

<b>Grupi 1: VENDI-MMARRËSIT</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>NJQV-të: Kryetarët e Bashkive, Këshilltarët Bashkiakë, Drejtorët e Drejtorive Financiare, Anëtarët e Bordeve Mbikëqyrëse të Shoqërive</li><li>ShUK: Menaxherët e Përgjithshëm, Menaxherët e Financave, Menaxherët Teknikë, Anëtarët e Bordeve Menaxhuese/Mbikëqyrëse të ShUK-ve</li></ul>
<b>Grupi 2: MENAXHIMI I LARTË</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>NJQV-të: Drejtuesit e Departamenteve të Çështjeve Bashkiake, Drejtuesit e Departamenteve të Planifikimit dhe Analizës, Drejtuesit e Departamenteve të Zhvillimit</li><li>ShUK: Stafi i Departamenteve të Ekonomisë dhe Financave, Drejtuesit e Departamenteve të Planifikimit dhe Analizës, Drejtuesit e Departamenteve të Zhvillimit, Drejtuesit e Departamenteve të Kontabilitetit</li></ul>


## Metodologjia

Ofrimi i Programit të Aksesit në Financim ndjek ciklin standard D-LeaP me tre seminare, me detyra për pjesëmarrësit dhe me mbështetje nga trajnerët mes fazave të ndryshme.

Aktivitetet fillestare dhe të ndërmjetme për Ngritjen e Kapaciteteve (NK) organizohen për të dyja grupet e synuara

individualisht në formatin e një trajnimi (për drejtuesit e lartë) ose si shkëmbim mes kolegësh (për vendimmarrësit).

Aktiviteti përfundimtar organizohet si shkëmbim mes kolegësh për të dyja grupet e synuara së bashku për të përmbledhur, për të shkëmbyer rezultatet dhe për të rënë dakord për rrugën përpara.



# Modulet

## A1


- paraqet sfidat kryesore që hasen në procesin e riorganizimit të ofrimit të shërbimeve të ujit dhe në përmirësimin e performancës së biznesit
- identifikon rolet dhe përgjegjësitë kryesore të palëve të interesuara, d.m.th. njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqëritë e shërbimeve publike në procesin e kryerjes së një vetëvlerësimi të shërbimeve që ata ofrojnë
- demonstroi se si punohet me rezultatet e përfutura nga vetëvlerësimi për hartimin e një plani për optimizimin e performancës duke u fokusuar në prioritetet e vendosura

## A2

- nënvizon elementet kryesore të praktikave të mira që lidhen me zhvillimin dhe me miratimin e një studimi fizibiliteti
- demonstroi rolet dhe përgjegjësitë kryesore të aktorëve kryesorë si të NJQV-ve, ShUK-ve, Njësitë të Zbatimit të Projekteve, IFN-ve dhe Konsulentëve
- familjarizon pjesëmarrësit me procesin e negociatave me IFN-të

## 3

- prezantoi praktika të mira në lidhje me zhvillimin dhe miratimin e një plani veprimi për qëndrueshmërinë financiare në mënyrë që të arrihet aftësia kreditore
- demonstroi rolet dhe përgjegjësitë kryesore të palëve kryesore të interesuara në procesin e arritjes së qëndrueshmërisë financiare



## B1

- i njeh pjesëmarrësit me aspektet unike të shërbimeve të ujit, me pasqyrat financiare dhe me funksionimin dhe performancën financiare të shoqërive
- demonstroi se si lexohen, si interpretohen dhe si vlerësohen pasqyrat financiare dhe treguesit operacionalë dhe financiarë të performancës
- prezantoi konceptet e financave për investimet dhe vendimet financiare si dhe analizën financiare dhe ekonomike të investimit

## B2

- familjarizon pjesëmarrësit me qëndrueshmërinë financiare dhe me kreditueshmërinë e shoqërive dhe se si ajo ndikon në aksesin në burime të ndryshme financimi
- prezantoi menaxhimin e shpenzimeve dhe të ardhurave
- identifikoi burimet e mundshme të financimit duke përfshirë menaxhimin e ciklit të projekteve dhe financimet e kombinuara



# Aksesi në financim: Financimi i Shërbimeve të Bashkive të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

## Përshkrimi i programit dhe temat e mbuluara

Ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve shpesh identifikojnë investime afatmesme (për matjet, efikasitetin e energjisë, rinovimin e aseteve), të cilat janë financiarisht të qëndrueshme, por janë shumë të mëdha për t'u financuar me fondet e vetë ndërmarrjeve dhe shumë të vogla për burimet si fondet e BE-së apo IFN-të. Nga ana tjetër, arritja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe të vepruarit në përputhje me direktivat e BE-së në lidhje me ujën do të kërkojë një rritje të konsiderueshme të financimeve për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, përtej sektorit publik dhe financimeve përmes koncesioneve. Kështu, qeveritë dhe shoqëritë duhet të përdorin të gjitha instrumentet dhe burimet e disponueshme dhe të fokusohen në masat për përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimeve.

Ky program është zhvilluar bazuar në dy kurse trajnimi të ofruara nga Banka Botërore në nivel global, që janë Kursi i Kreditueshmërisë dhe Kursi për Performancën dhe Financat e Ujësjellësve. Objektivi kryesor është përmirësimi i njohurive dhe aftësive mbi konceptet bazë financiare dhe mbi menaxhimin e aspekteve financiare, të cilat janë thelbësore për të menaxhuar në mënyrë efektive të ardhurat dhe për të mbuluar kostot, duke përfshirë praktikën e kontabilitetit, menaxhimin e aseteve, vendosjen e tarifave, vlerësimin e investimeve dhe aksesin në financim.

Programi do të ofrohet nga Hub-et kombëtare në gjuhët lokale dhe shoqëritë pjesëmarrëse do të paguajnë një tarifë regjistrimi, e cila do të komunikohet nga Hub-et përkatëse.

### Ngritja e programeve D-LeaP

Ky program është hartuar mbi parimet e të mësuarit përmes praktikës. Ai përfshin një kombinim të trajnimeve ballë-për-ballë me ofrimin e mjeteve dhe teknikave për adresimin e sfidave me të cilat përballen shoqëritë duke i zbatuar ato në praktikë, pasuar nga trajnimi në kushte pune, ku shoqëritë pjesëmarrëse aplikojnë mjetet dhe teknikat e mësuara në situatat e tyre specifike dhe zhvillojnë produkte konkrete (diagnostikim, plane veprimi etj.). Programi aplikon parimet e të mësuarit të kombinuar, d.m.th. kombinohen trajnimet ballë-për-ballë me materialet mësimore elektronike që ofrohen në kuadër të Akademisë D-LeaP.

Për më shumë informacion mbi konceptin dhe strukturën e Programit, ju lutemi vizitoni [www.d-leap.org](http://www.d-leap.org)!

### Çfarë mësohet në këtë program?

Ç'do të thotë qëndrueshmëri financiare dhe aftësi kredituese?

Si lexohen dhe si interpretohen pasqyrat financiare të shërbimeve UK?

Si zhvillohet një plan për optimizimin e performancës?

Si identifikohen burimet e mundshme të financimit?

### Hub-et



Rrjeti Aquasan në Bosnje dhe Hercegovinë (Aquasan)



Water Supply and Sewerage Association of Albania (SHUKALB)/ Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve të Kosovës (SHUKOS)



Shoqata e Ofruesve të Shërbimeve Komunale të Maqedonisë (ADKOM)



Shoqata Bullgare e Ujit (BWA)

### Partner teknik



### Kontakt

D-LeaP Sekretariat  
office@iawd.at

